



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 309/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosjes (LVV) dega në Rahovec, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Rahovec, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike për Kryetar, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV) dega në Rahovec.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 22.10.2013, nga subjekti politik LVV dega në Rahovec, në të cilën theksohet se me datën 20 tetor 2013, rreth orës 20:00, në rrugën R II 0 (magjistranja për fshatin Xërxë), është vendosur baneri i kandidatit për kryetar të Komunës nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Idriz Vehapi, ku me këtë veprim sipas parashtruesit të ankesës janë shkëlur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, neni 33 pika b) dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografit si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013, në ora 12:00 sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, në të cilën thekson se pretendimet e LVV janë të pabaza lidhur me shkëljen e rregullave të përcaktuara me nenin 33 pika b) të LZP-së, dhe nenit 3, 4 të Rregullores 11/ 2013 të KQZ-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore mëtutje në përgjigjen në ankesë PDK theksohet se sipas të dhënave që kemi nga tereni, persona të paautorizuara kanë keqpërdorur banerin e kandidatit për kryetar të Komunës së Rahovecit nga radhët e PDK-së. Po ashtu në përgjigjen në ankesë PDK thekson se sipas të dhënave me të pranuar njoftimin aktivistët e PDK-së kanë shkuar në vendin e caktuar dhe kanë hequr banerin e kandidatit për kryetar të Komunës së Rahovecit dhe vlerëson që është e padrejtë dhe pa asnjë fakt t'i adresohet PDK kjo ankesë dhe se kërkon nga PZAP që ta hudh ankesën poshtë si të pabazë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi nga fotografit e ofruar si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet se subjekti politik PDK ka bërë vendosjen e banerit në vende publike, siç pretendohet në ankesë, andaj PZAP-i pretendimet e tilla i vlerëson si të përgjithshme dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 309/2013 më datën 25.10.2013



**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**

Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.